



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 1 pika 5 të Udhëzimit administrativ nr.06/2010 për mënyrën dhe procedurat e shitjes së trungjeve pyjore dhe asortimenteve drusore nga pyjet publike dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunes, nxjerr

**VENDIM
PËR SHITJEN E MASËS DRUSORE**

Neni 1

TË SHITET, masa drusore e konfiskuar, cila gjendet në oborr të Shkollës së mesme bujqësore "Adem Gllavica" në Lipjan konform Kërkesës së Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari e datës 25.11.2016.

Neni 2

Shitja e masës drusore e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të zhvillohet nëpërmjet procedurës së ankandit publik.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari dhe Drejtorati për Prokurim.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

1Nr.322-65093

Lipjan, më 01.12.2016

